
JETË SHKENCORE

**SIMPOZIUM SHKENCOR ME RASTIN E 100-VJETORIT
TË LINDJES SË HEROIT TË POPULLIT
BABA FAJA MARTANESHI**

Në kuadër të aktiviteteve shkencore më dt. 23 dhjetor 2010 në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave u organizua nga Instituti i Historisë, Komuna Martanesh dhe Shoqata Atdhetare – Kulturore e kësaj treve, sesioni përkujtimor me temë “Tribuni i lirisë Baba Faja Martaneshi”.

Në të morën pjesë historianë, studiues, intelektualë, gazetarë e personalitete të tjera të shkencës. Morën pjesë gjithashtu edhe përfaqësues të komunës së Martaneshit e të trevave të tjera të Çermenikës dhe të Dibrës.

Sesioni u drejtua nga drejtori i Institutit të Historisë, Tiranë, akademik prof. dr. Beqir Meta i cili hapi dhe punimet e këtij sesioni.

Në fjalën e hapjes akademik Beqir Meta nënvizoi faktin që për figurën e Baba Faja Martaneshit në të kaluarën edhe është folur por edhe është lënë në heshtje. Ai theksoi që me punën e studiuesve të rinj ka ardhur koha që edhe ndaj figurës së Baba Faja Martaneshit të hidhet dritë në tërë kontributin e tij të veçantë e lidhur kjo edhe me krahinën që ai përfaqësoi në Luftën Antifashiste për liri.

Në këtë aktivitet përshëndeti Kryetari i Akademisë së Shkencave Akademik Gudar Beqiraj, i cili vlerësoi lart kontributin e Baba Faja Martaneshit në Luftën e Dytë Botërore si nacionalist e antifashist i orëve të para. Ai përgëzoi organizuesit për këto nisma dhe i inkurajoi ato për ta vazhduar më tej punën e tyre. Akademik Gudar Beqiraj, duke folur për figurën e Baba Fajës, u ndal tek krahina e Martaneshit duke ngritur lart vlerat patriotike, antifashiste të kësaj treve aq të njohur dhe të rëndësishme të Shqipërisë.

Po ashtu përshëndeti dhe përfaqësuesi i Kryegjyshitës Botërore Bektashiane z. Ilir Dedei, i cili ngriti lart figurën e Baba Fajës si klerik i kulluar që për lirinë e atdheut shkriu gjithçka që ai pati si patriot e atdhetar i flaktë.

Simpoziumin në emër të nënës së tij, bashkëshortes së Baba Faja Martaneshit (Farie Khanit) dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes e përshëndeti djali i Baba Fajës, prof. dr. Mustafa Xhani. Ai falënderoi organizatorët, studiuesit, historianët si dhe banorët e mirë e trima të trevës me emër të Martaneshit që mbështetën pa rezerva luftën për liri dhe bashkë me Baba Fajën krijuan emër të nderuar në historinë e kombit shqiptar.

Aktivitetin e përshëndeti Kryetari i Komunës dhe Kryetari i Shoqatës “Martaneshi” Ing. Gazmend Kenga dhe Skënder Gjoni, të cilët vlerësuan me fjalët më të veçanta rolin dhe kontributin e Baba Fajës në historinë e Martaneshit.

Po ashtu përshëndetën dhe përfaqësues të trevave të Çermenikës e Dibrës ku Çermenika në kuadër të 100-vjetorit e kishte shpallur Baba Faja Martaneshin qytetar nderi, vlerësim që iu dha nga kryetari i komunës.

Më tej sesioni vazhdoi me mbajtjen e kumtesave.

Dr. Teki Kurti mbajti kumtesën “Vendi i Baba Fajës në historinë e Martaneshit”. Kjo kumtesë e nxirrte portretin e Baba Fajës nëpërmjet ditareve të tij të mbajtura gjatë luftës.

Prof. dr. Muharrem Dezhgiu mbajti kumtesën “Baba Faja Martaneshi në dokumente italiane dhe gjermane (1939-1944)”. Në këtë kumtesë u pasqyruan gjithë dokumentat e shtabeve ushtarake të ushtrive pushtuese në Shqipëri (italiane dhe gjermane).

Akademik Beqir Meta mbajti kumtesën “Refleksione historiografike mbi personalitetin e Baba Faja Martaneshit”. Ai e vuri theksin tek dokumentet që i ishin fshehur historisë e që flisnin ndryshe për Baba Faja Martaneshin. Kështu ai nënvizon faktin që në luftë Baba Faja Martaneshi orientimin dhe mbështetjen e parë e ka marrë nga Mustafa Gjinishi.

Në këtë aktivitet kumtesën me temë “Figura e Baba Fajës në vështrimin e anglo-amerikanëve” e mbajti prof. dr. Hamit Kaba. Kjo kumtesë sillte në analizë dokumenta të panjohura më parë të marra nga arkiva britanike dhe amerikane. Ai trajtoi bashkëpunimin e Baba Fajës me anglo-amerikanët në Luftën e Dytë Botërore.

Kurse prof. dr. Shaban Sinani mbajti kumtesën “Baba Faja Martaneshi” në kujtimet e bashkëkohësve”. Ai solli të analizuar nëpërmjet kujtimeve të njerëzve të afërt dhe atyre që jetuan afër tij portretin e heroit klerik, luftëtar dhe një ndër drejtuesit e luftës për liri, në Shqipëri në vitet 1939-1944.

Rreth figurës së Baba Faja Martaneshit pati dhe shumë nga pjesëmarrësit që donin të merrnin fjalën në punimet e sesionit, duke mbështetur ato që u folën për këtë figurë por duke e ngritur akoma më lart atë.

Në fund të punimeve u shfaq edhe një dokumentar televiziv i realizuar nga Televizioni Publik Shqiptar për figurën e Baba Faja Martaneshit.

Në mbyllje të sesionit Dr. Teki Kurti përgëzoi referuesit për trajtesat e tyre, për vlerësimet që i bënë figurës së Baba Fajës si dhe për mundësitë që na hapen, për të nxjerrë në pah sa më mirë dhe sa më të plotë rolin e këtij patrioti në Luftën Antifashiste të popullit shqiptar si dhe për ta vënë atë në vendin e mohuar dhe për ta vendosur në vendin që meriton në historinë shqiptare.

Teki KURTI